



11/01/2023

Shkodër/Vijon Operacioni Policor I Koduar "Kontigjenti"

Shkodër/Vijon operacioni policor i koduar "Kontigjenti".

Qarkullonte me lëndë narkotike me vete, braktisi automjetin dhe duke përfutur nga kushtet e errësirës, iu shmang shërbimeve të Policisë, kapet brenda 24 orëve dhe vihet në pranga 22-vjeçari.

Në automjetin e 22-vjeçarit udhëtonte edhe një shtetas tjetër, i armatosur me pistoletë, i cili u arrestua në kuadër të operacionit "Kontigjenti", të zhvilluar një ditë më parë.

Si rezultat i veprimeve të shpejta dhe profesionale policore, të kryera në kuadër të operacionit policor të koduar “Kontigjenti”, të zhvilluar ditën e djeshme, gjatë të cilit u vu në pranga shtetasi B. C. dhe u sekuestruan 1 armë zjarri pistoletë dhe një sasi lënde narkotike kanabis, shërbimet e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve të DVP Shkodër lokalizuan, kapën dhe vunë në pranga, brenda 24-orëve, shtetasin e shpallur në kërkim:

-T. P., 22 vjeç, banues në Shkodër.



Shërbimet e Policisë, gjatë kontrollit të ushtruar në automjetin e drejtuar nga shtetasi T. P., gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale, një sasi lënde narkotike kanabis. 22-vjeçari tashmë i arrestuar, duke përfituar nga kushtet e errësirës, braktisi automjetin e ndaluar për kontroll, në kuadër të operacionit policor "Kontigjenti".

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për veprat penale “Prodhim dhe shitja e narkotikëve” dhe “Mosbindja ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik”.

Kärko



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linq

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent